Trusti

FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE I KOSOVËS



PLANI I PERFORMANCËS PËR VITIN 2027

Trusti

FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE I KOSOVËS
KOSOVO PENSION SAVINGS TRUST
KOSOVSKI PENZIJSKI ŠTEDNI FOND

PËRGATITUR :
Prishtinë, tetor 2026

Kontakt:
Rr. “Perandori Justinian” Nr. 71, Prishtinë
www.trusti.org || info@trusti.org || 038-600-020

PËRMBAJTJA

1 Hyrje

2 Mandati

3 Funksionet dhe përgjegjësitë

4 Aktivitetet

5 Synimet kryesore për vitin 2027

6 Struktura organizative e FKPK-së

7 Njësitë organizative dhe detyrat

8 Matrica e planit të veprimit për vitin 2027

9 Projeksioni dhe plani i të hyrave për vitin 2027

AKRONIMET

FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
Qeveria	Qeveria e Republikës së Kosovës
Kuvendi	Kuvendi i Republikës së Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Bordi	Bordi Drejtues i FKPK-së
MNM	Mjetet Neto nën Menaxhim
DPI	Deklarata e Parimeve të Investimeve

1. Hyrje

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) është institucion publik i pavarur dhe jo-për-profit, i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. FKPK-ja është e projektuar sipas modelit të kontributeve pensionale të definuara, ashtu që secilit kontributdhënës të ketë të hapur llogarinë personale e kursimeve pensionale në këtë institucion.

Në llogarinë personale ruhen të gjithë informacionet dhe përmes saj kryhen të gjitha transaksionet hyrëse, investuese dhe dalëse. FKPK-ja është themeluar në dhjetor të vitit 2001 dhe ka filluar aktivitetin në gusht të vitit 2002 – për t'i administruar dhe menaxhuar kontributet e obligueshme pensionale (dhe mbi to ato shtesë - vullnetare) të të punësuarve në Kosovë.

Aktivitetin e përgjithshëm të FKPK-së e rregullon Kuvendi i Kosovës, ndërsa mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë e realizon Banka Qendrore e Kosovës (BQK). FKPK-ja është e angazhuar kryekëput për mbajtjen në mirëbesim (përfshirë investimin) e kontributeve pensionale të kursyera nga qytetarët e Kosovës – si të punësuar ose të vetëpunësuar.

Administrimi i llogarive individuale është përgjegjësi ligjore, megjithatë paratë e kursyera mbesin pronë vetanake e kontribuuesve. Por, edhe pse pronë vetanake, mandati i kursimeve pensionale është specifik: ato mund të përdoren vetëm për pension – dhe nuk mund të shfrytëzohen për asnjë arsye tjetër e as të tërhiqen përpara moshës së pensionimit (p.sh nuk mund të merren për hua, për trajtime mjekësore e të ngjashme).

Institucioni, tashmë 25 vjet pas themelimit, e ka një përvojë të dëshmuar të administrimit dhe menaxhimit në mirëbesim të kursimeve pensionale, duke ua ruajtur dhe shtuar vlerën e mjeteve pensionale përmes investimeve të matura në tregjet financiare ndërkombëtare por edhe në Kosovë.

Ndërsa mjetet nën menaxhim tashmë kanë arritur në mbi 4.3 miliardë euro, dhe numri i llogarive të përgjithshme mbi 1 milion llogari, institucioni i ka 38 anëtarë të përhershëm të stafit dhe me zyrën e vetme në Prishtinë.

FKPK-ja ngrihet mbi dy shtyllat kryesore në operim: atë të investimeve dhe tjetrën të operacioneve. Që të dyja gërshetojnë planet e veprimit si në rrafshin strategjik ashtu edhe atë operativ, për të përmbushur obligimet ligjore por edhe shërbyer më së miri nevojave të kontribuuesve.

Historikisht, prej themelimit, Kuvendi e ka mbikëqyrur FKPK-në përmes raporteve vjetore, ku përfshihen edhe pasqyrat e audituara financiare; si dhe përmes diskutimit e miratimit të tarifave menaxhuese, ku përfshihet edhe plani financiar dhe i performancës për vitin e ardhshëm.

Nëse ka nevojë, Kuvendi përmes komisioneve funksionale, gjithashtu realizon takime të jashtëzakonshme informuese me përfaqësuesit e FKPK-së. Në këtë mënyrë Kuvendit i është dhënë hapësirë e mjaftueshme për vlerësimin e drejtpërdrejtë të mbarëvajtjes së institucionit.

Ky plan i performancës, i dedikuar për Kuvendin e Republikës së Kosovës, synon të kristalizojë informacione të ndryshme dhe kryesore të planifikimit njëvjeçar të institucionet, për t'i ndihmuar anëtarëve të Kuvendit të mbikëqyrin, përcjellin e t'i paraprijnë planifikimit afatshkurtër të institucionit.

Andaj përveç aktiviteteve të pritshme vjetore, këtij plani i bashkëngjitet edhe planifikimi i tarifave dhe të hyrave financiare për vitin 2027.

2. Mandati

Mandati ligjor i FKPK-së është t'i administrojë dhe menaxhojë kursimet pensionale deri në pensionimin e kontribuuesve. Këto përgjegjësi janë për investimin e mjeteve pensionale, sipas parimeve që burojnë nga legjislacioni në fuqi, si dhe ofrimin e shërbimeve për kontribuuesit përgjatë ciklit të kontribuimit. FKPK-ja i investon mjetet pensionale ashtu që kontribut-dhënësve t'iu rritet vlera e kursimeve pensionale, dhe që kështu në afatgjatë t'iu ruhet fuqia blerëse e kursimeve pensionale.

Për këtë arsye, Bordi i FKPK-së e ka përcaktuar si vlerë krahasimore (bençmark) mbulimin e inflacionit me disa pikë bazë shtesë (varësisht prej portofolit), gjithnjë duke e pasur parasysh jetëgjatësinë e investimeve të fondeve pensionale të akumuluara.

Përveç kësaj, me qëllim menaxhimin e duhur të riskut investues, kontribuuesit janë shpërndarë në tre portofola investues sipas moshës së tyre, sikurse vijon:
1) Portofoli Standard (për moshën 15 deri 57 vjeçare)
2) Portofoli i Balancuar (për moshën 58 deri 62 vjeçare) dhe
3) Portofoli Konservativ (për moshën 63 vjeçare e sipër).

Investimet e mjeteve pensionale bëhen në klasa të ndryshme investuese, me shpërndarje të gjerë gjeografike (globale dhe në Kosovë) dhe industri të shumta, në mënyrë që të shpërndahet (dhe kështu edhe zvogëlohet) rreziku i mundshëm nga investimet, sikurse vlerësohet e arsyeshme nga Bordi.

Ligji Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë, së bashku me amandamentimet e tij, ia jep FKPK-së (përmes Bordit Drejtues), kompetencat dhe të drejtat e administruesit të besuar për fondet pensionale (Neni 5.1), dhe i përcakton asaj të drejtat lidhur me fondet pensionale duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në (Neni 5.2), por edhe:

• Udhëheqjen e procesit për përzgjedhjen e menaxhues- it/ëve të mjeteve dhe mbajtësit të mjeteve ose instrumenteve për investime të hapura, në pajtim me ligjet në fuqi.

• Përgatitjen e buxhetit vjetor (për investime dhe operacione).

• Zbatimin e marrëveshjeve me menaxhues-in/it e mjeteve, mbajtësit e instrumenteve për investime të hapura, llogaritarët, revizorët, avokatët dhe kryerësit e tjerë të shërbimeve për FKPK-në.

• Kërkimin dhe pranimin e informacionit nga drejtorët e mjeteve të instrumenteve për investime të hapura, nga mbajtësit e mjeteve dhe kryerësit e tjerë të shërbimeve për të gjitha transaksionet në emër të FKPK-së, duke përfshirë edhe votimin e aksioneve që FKPK-ja i mban.

• Përcaktimin e parimeve për investimet e FKPK-së.

• Shkarkimin dhe zëvendësimin e drejtorit të mjeteve të instrumenteve për investime të hapura, mbajtësve të mjeteve dhe kryerësve të tjerë të shërbimeve të FKPK-së.

• Pagimin e fitimeve të llogarive individuale për pensionet e kursyera siguruesve të anuiteteve me qëllim të blerjes së pensioneve për pjesëmarrësit dhe përfituesit në përputhje me këtë ligj.

• Lidhjen e marrëveshjeve për blerjen, shitjen, dhënien ose marrjen me qira të patundshmërive apo pajisjeve të nevojshme për funksionimin e FKPK-së.

• Punësimin e personelit ekzekutiv dhe jo-ekzekutiv.

• Lidhjen e marrëveshjeve të sigurimeve, duke e përfshirë edhe sigurimin fiduciar për anëtarët e Bordit, me kompanitë e sigurimeve të licencuara në Kosovë ose në shtetet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik.

• Caktimin e tarifave të arsyeshme vjetore, të bazuara në shpenzime, ndaj llogarisë së çdo pjesëmarrësi për administrimin e llogarive individuale - të miratuara paraprakisht nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

• FKPK-ja e ka zyrën e saj kryesore dhe të vetme në Prishtinë. Ndërsa shërbime për kontribuuesit dhe përfituesit e kursimeve për pension kryhen edhe në gjashtë qendrat e tjera të Administratës Tatimore të Kosovës në: Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Gjilan, Prizren dhe Ferizaj, përmes zyrtarëve pensionalë, të cilët janë staf i ATK-së.

3. Funksionet dhe përgjegjësitë

FKPK-ja i ka të punësuar staf me përvojë me kontrata të përhershme, funksioni i të cilëve është t'i pranojnë dhe t'i procesojnë kontributet nga punonjësit dhe punëdhënësit, dhe t'iu ofrojnë këshilla dhe përkrahje teknike të gjithë kontribuuesve dhe palëve të interesit.

Tutje, funksionimin e saj FKPK-ja e ka të ndarë nëpër njësitë kryesore: investimet, raportimi dhe mbikëqyrja, marrëdhëniet me klientë, financat, marrëdhëniet me publik, burimet njerëzore, teknologjinë informative, çështjet ligjore dhe auditimin e brendshëm.

Struktura institucionale është e dizajnuar për t'i menaxhuar me efikasitet llogaritë personale, për t'i mbajtur shënimet e kontributeve, ofruar një spektër të gjerë të shërbimeve për klientë dhe informuar publikun për çështjet e implementimit të programit pensional.

Punëdhënësit e deklarojnë obligimin për pagesë të kontributeve pensionale përmes sistemit online të deklarimit në ATK. Deklarimi bëhet përmes ngarkimit të listës së të punësuarve në sistemin e deklarimit online (EDI). Pas deklarimit, EDI i prodhon fletëpagesat përkatëse, përmes të cilave bëhet pagesa në cilëndo prej bankave komerciale ose institucioneve të licencuara për pagesa të tilla në Republikën e Kosovës.

Nëse të punësuarit janë identifikuar saktë në listën e deklaruar në sistem, dhe nëse pagesa është bërë në përputhje me rregullat, (zakonisht) për tri deri në pesë ditë pune kontributet pensionale kalohen në llogaritë individuale të kursimeve pensionale në FKPK.

Kontributet e mbledhura investohen në tregjet globale financiare, me qëllim të rritjes së vlerës, ndërkaq kthimi nga investimet shpërndahet proporcionalisht nëpër llogaritë individuale. Për ta menaxhuar më mirë riskun investues, prej shkurtit 2022 ka filluar përshtatja e riskut investues me moshën e kontribuuesve dhe në prill 2024 janë krijuar tre portofola investues.

FKPK-ja ngarkon tarifa vjetore mbi mjetet pensionale për t'i ushtruar funksionet dhe përgjegjësitë e saj.

3.1 Bordi Drejtues
FKPK-ja udhëhiqet nga Bordi Drejtues, i cili përbëhet nga tetë anëtarë: pesë anëtarë me përvojë së paku 10-vjeçare në lëmin e pensioneve ose investimeve; dy anëtarë me përvojë në përfaqësimin (njëri i punëdhënësve dhe tjetri i të punësuarve); si dhe një përfaqësues i Qeverisë së Kosovës, pa të drejtë vote.


Shtatë anëtarët e Bordit (me të drejtë vote) emërohen nga Kuvendi i Kosovës me mandat katërvjeçar, me mundësi të rizgjedhjes. Nëse mandati i anëtarëve të Bordit skadon dhe anëtarët e rinj nuk janë emëruar, atëherë anëtarëve ekzistues të Bordit iu vazhdohet mandati vetëm për nëntëdhjetë ditë.

3.2 Administrata
Administrata e FKPK-së drejtohet nga Menaxhmenti i lartë, i cili përbëhet nga Drejtori Menaxhues, Drejtori për Financa dhe TI, Drejtori për Operacione dhe Drejtori për Investime.

Menaxhmenti synon që të angazhojë në FKPK individë efektivë, profesionalë dhe integritet të lartë, duke besuar se vetëm këto cilësi do të çojnë në progres më të madh, mjedis të përshtatshëm për pune, në shërbime më të mira për kontribuuesit, por edhe (kryesorja) në ruajtjen e integritetit institucional të FKPK-së.

Për t'i arritur objektivat e mësipërme, Bordi dhe Menaxhmenti, kujdesen të sigurojnë që Administrata aktuale të vazhdojë t'i përmirësojë njohuritë dhe përvojën, të jetë e motivuar, dhe të vë në funksion të gjitha kapacitetet mendore dhe profesionale në shërbim të avancimit të proceseve të brendshme dhe shërbimeve për klientë.





4. Aktivitetet

Aktivitetet e FKPK-së fillojnë nga pranimi i kontributeve pensionale prej ATK-së. Kjo arrihet përmes konfirmimit dhe barazimit të kontributeve nëpër llogaritë individuale në FKPK. Në rast të mosbarazimit (ose mungesës së raporteve të nevojshme), stafi i FKPK-së koordinohet me stafin e ATK-së, por edhe me punëdhënësit përkatës, për t'i gjetur informacionet e për t'i barazuar kontributet e paguara pensionale.

Njëkohësisht, bashkë me mjetet, nga ATK-ja dërgohet edhe informacioni për secilin kontribuues në sistemin kryesor për menaxhimin e llogarive të FKPK-së, e po ashtu tek llogaritë e kontribuuesve, që janë të regjistruar në shërbimin eTrusti. Mjetet e pabarazuara, ose që nuk janë kontribute, Kthehen mbrapsht në ATK, sipas legjislacionit në fuqi.

Investimi i mjeteve nën menaxhim është aktiviteti tjetër, ndër më të rëndësishmit, i institucionit. Vendimet për investimet janë deleguar nga Bordi Drejtues tek Komisioni për Investime i Bordit dhe Bordi Menaxherial, të cilët ndihmohen dhe nga stafi tjetër profesional i FKPK-së - përmes të dhënave, analizave e informacione specifike.

Procesi i investimit të mjeteve, ashtu sikurse ai i tërheqjes, kërkon një sërë veprimesh vendimmarrëse e administrative deri në realizim. Shumica e mjeteve nën menaxhim vazhdojnë të investohen në tregjet financiare ndërkombëtare (pra jashtë vendit), meqë ende nuk ka mundësi të mjaftueshme (ligjore) për t'i investuar ato më shumë në Kosovë. Megjithatë FKPK-ja vazhdimisht shpreh interesimin për më shumë investime të mjeteve brenda vendit.

Hallka e tretë e aktiviteteve kryesore të institucionit është procesimi i pagesave nga llogaritë e pensionuara në FKPK drejt bankave përkatëse në Kosovë. Kuptohet se përveç pranimit të kërkesave për pensionim, dhe realizimit të pagesave përkatëse, ka veprime që merren si për përgatitjen e marrëveshjeve me bankat, për tërheqjet në faza të pensioneve (kjo për bilancet e kursimeve pensionale mbi 3 mijë euro), ashtu edhe pas aplikimit për pension, sa herë ka kërkesa për informim e ndihmë ndaj kontribuuesve.

Përveç këtyre aktiviteteve, institucioni ka përgjegjësi ditore në mirëmbajtjen e sistemit për përditësimin e të dhënave të të gjithë kontribuuesve, sigurinë dhe ruajtjen e atyre të dhënave, ofrimin e shërbimeve ditore, raportimin e vazhdueshëm, komunikimin dhe informimin pa ndërprerje dhe përgjigjjen ndaj të gjitha kërkesave të palëve të treta (institucioneve, mediave, OJQ-ve, studentëve dhe individëve të tjerë).

Qysh prej themelimit FKPK-ja i ka kushtuar vëmendje të rëndësishme transparencës. Andaj, përveç raportimit të rregullt institucional, çdo informacion i rëndësishëm publikohet në uebfaqen e FKPK-së.

Gjithashtu, në këtë frymë, institucioni prej vitit 2008 ka filluar ta ofrojë shërbimin e qasjes në llogarinë e kursimeve pensionale përmes internetit (në portalin eTrusti). Tashmë janë mbi 378 mijë kontribuues që e janë regjistruar në këtë shërbim. Përgjithësisht institucioni ka synuar përdorimin sa më të madh të proceseve dhe shërbimeve digjitale, të bazuara në internet, si mënyrë më praktike dhe me kosto më të ulët e shërbimit dhe komunikimit.

Megjithatë, këto vendimenuk janë marrë pa e analizuar riskun e mundshëm të sigurisë së të dhënave digjitale. Andaj FKPK-ja i përdorë teknologjitë më të fundit të shërbimit digjital që ofrohen dhe me standardet më të larta të sigurisë. Për ta lehtësuar informimin për kursimet pensionale, prej fundvitit 2023 shkarkimi i pasqyrës së FKPK-së mund të bëhet edhe nga eKosova, bazuar në marrëveshjen e përbashkët me institucionet përgjegjëse të Kosovës.

Fushëveprimtaria e FKPK-së mbikëqyret në baza ditore nga Auditori i Brendshëm i FKPK-së, ndërsa në baza tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore nga Auditori i Jashtëm dhe Banka Qendrore e Kosovës.

Njëkohësisht, institucioni i raporton (e edhe mbikëqyret) nga Komisioni i Kuvendit për Mbikëqyrje Financiare por edhe nga vetë Kuvendi i Kosovës, përmes shqyrtimit të tarifave vjetore të menaxhimit dhe diskutimit e miratimit të planit vjetor dhe raporteve vjetore.

4.1 Arkëtimi i kontributeve pensionale

Arkëtimi i kontributeve pensionale dhe i raporteve përkatëse është përgjegjësi ligjore e ATK-së. Megjithatë, FKPK-ja bashkëpunon ngushtë me ATK-në por edhe punëdhënësit individualisht, që të dhënat e kontributeve pensionale të jenë të sakta e të plota.

Numri dhe vlera e kontributeve pensionale ka vazhduar të ketë trend të ngritjes prej themelimit. Kjo ndodh, si për shkak të rritjes së vazhdueshme të të ardhurave, nga rritja e numrit të kontribuuesve aktivë, por edhe ngritjes së vetëdijësimit të kontribuuesve për rëndësinë e pagesës së rregullt të kontributeve pensionale.

Për vitin 2027 nuk pritën ndryshime të mëdha në pagesat mujrore të kontributeve – bazuar në rrjedhën e kontribuimit të këtij viti dhe nivelet e pagesave aktuale.


Në tabelat vijuese paraqiten të dhënat për shumën dhe numrin e kontribuuesve në pesë vjetët e fundit dhe llogaritë e reja dhe vlerën e kontribuimit për 2026.

Numri i kontribuuesve aktivë dhe vlera e kontributeve pensionale përgjatë periudhës 2021 - 2025

Periudha	Numri i kontribuuesve aktivë në fundviti	Numri i llogarive të reja gjatë vitit	Vlera e kontributeve të reja për vitin
2021	419,657	45,290	€213,450,809
2022	428,891	40,409	€241,462,429
2023	442,383	41,968	€286,181,346
2024	452,366	39,231	€315,807,132
2025	470,283	37,956	€364,281,055

Numri i kontribuuesve aktivë dhe vlera e kontributeve sipas muajve të vitit 2026

Periudha	Numri i llogarive të reja gjatë muajit	Vlera e kontributeve të reja
Janar	2,450	€34,191,695
Mars	2,925	€30,683,663
Shkurt	1,979	€38,347,685
Prill	2,563	€36,732,559
Maj	2,972	€36,118,527
Qershor	3,527	€32,707,594
Korrik	4,843	€39,506,037
Gusht	3,342	€35,212,409



4.2 Investimi i mjeteve pensionale

FKPK-ja i investon mjetet nën menaxhim në harmoni DPI-në dhe në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-115, Ligjin Nr. 04/L-168 dhe Ligjin Nr. 05/L-116 si dhe rregullat dhe rregulloret përkatëse të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK).

DPI-ja i përcakton një sërë parimesh dhe politikash udhëzuese për të ofruar një kornizë pune objektive, efektive dhe transparente për një proces të qëndrueshëm në vendimmarrje për investimin e mjeteve pensionale.

DPI-ja rishikohet çdo vit nga Bordi, nëpërmjet Komisionit të Investimeve të FKPK-së, dhe pa vonesë, nëse do të ndodhë ndonjë ndryshim i rëndësishëm në qasjen e investimit, objektivave, kufizimeve, tolerancës ndaj rrezikut, horizontit të investimeve, ose grupmoshave të pjesëmarrësve.

FKPK-ja i merr vendimet për investimet duke vepruar vetëm në interesin më të mirë të pjesëmarrësve, duke iu përmbajtur prioriteteve të mëposhtme, të përcaktuara në ligj:
1) Siguria e mjeteve pensionale;
2) Diversifikimi i investimeve
3) Kthimi maksimal nga investimet në përputhje me sigurinë e Mjeteve, dhe
4) Mirëmbajtja e likuiditetit të mjaftueshëm.

Bordi përpiqet të sigurojë që FKPK-ja të ketë:
a) Procese efektive dhe efikase të investimeve;
b) Nivel të duhur të ekspertizës për analiza dhe veprimtarinë e investimeve në përgjithësi; dhe
c) Qasje rigoroze për menaxhimin e shpenzimeve për investime dhe operacione.

Bordi do të marrë gjithashtu parasysh se:
(a) FKPK-ja është investitor afatgjatë;
(b) Ekziston nevoja për t'u diversifikuar në mënyrë efektive midis klasave të ndryshme të aseteve dhe brenda vetëm një klase të caktuar të aseteve;
(c) Megjithëse performanca investuese matet - dhe tërheqja e kursimeve i paguhet pjesëmarrësve - në euro, kjo nuk duhet ta kufizojë investimin vetëm në Euro asete; dhe
(d) Pjesëmarrësit duhet ta ruajnë besimin e tyre në institucionin e FKPK-së, prandaj dhe duhet mirëmbajtja e një politike të kujdesshme investuese.


Bordi Drejtues i ka përvetësuar një sërë bindjesh investuese, për të ofruar kështu një kornizë objektive dhe transparente për vendimmarrje të qëndrueshme të investimeve. Këto bindje veprojnë si udhëzues për kryerjen efektive të të gjitha funksioneve investuese.

Bindjet e Bordit Drejtues janë:
(a) FKPK-ja do të duhet të ndërmarrë rrezik investues për t'i përmbushur objektivat investuese.
(b) Klasa të ndryshme asetesh kanë karakteristika të ndryshme, varësisht tregjeve dhe cikleve të ndryshme ekonomike. Megjithatë, investitorët afatgjatë dhe të durueshëm, fitojnë kthime më të mira duke investuar në asete që pritet të kenë kthim dhe risk më të lartë, veçanërisht në aksione. FKPK-ja është pozicionuar mirë për të përfituar nga kjo, duke pasur parasysh profilin e moshës së pjesëmarrësve.
(c) Performanca afatgjatë është shumë më e rëndësishme sesa lëvizjet afatshkurtra; duke qenë se rëniet në tregjet financiare (zakonisht) jo vetëm që rikuperohen me kalimin e kohës, por gjithashtu ofrojnë mundësi investuese shtesë.
(d) Alokimi i mjeteve është faktor përcaktues në performancën afatgjatë.
(e) Diversifikimi është mjet i rëndësishëm për menaxhimin e riskut dhe kthimit nga investimet.
(f) Fondet pasive të indeksuara në përgjithësi ofrojnë qasje në një klasë asetesh me kosto më të ulët, shpesh me performancë më të mirë në afatgjatë.
(g) Menaxhimi aktiv ofron qasje të ndryshme investimi ndaj një klase të caktuar asetesh, duke zgjeruar shkallën e diversifikimit.
(h) Fondet aktive, qofshin të përbëra nga një ose më shumë klasa asetesh, përmes përzgjedhjes dinamike, pozicionimit në treg dhe/ose menaxhimit të riskut, mund të arrijnë kthime të qëndrueshme me më pak luhatshmëri.
(i) Një funksion i brendshëm investues, me ekspertizë, i mirë-qeverisur dhe me burime adekuate mund të ndihmojë në arritjen e rezultateve më të mira afatgjata.

Versioni i plotë i DPI-së mund të vizitohet përmes vegzës: https://trusti.org/sq/investimet/deklarata-e-parimeve/

Investimet, sipas fondeve investuese dhe plasmaneve në Kosovë, për Portofolin Standard më 31.08.2026:

Fondi investues / Institucioni	Shuma e investimit	% e investimit	Klasa e asetit / Strategjia
Vanguard GSIF	€893,885,682	24.5%	Aksione – Pasive / Rritje
Invesco S&P500 Eur Hedg ETF	€287,202,084	7.9%	
iShare MSCI Eur Value ETF	€138,895,982	3.8%	
Vanguard Value ETF	€88,060,039	2.4%	
iShares MSCI EM UCITS ETF	€83,118,337	2.3%	
Amundi MSCI Eu QualFact	€77,493,540	2.1%	
iShares Core FTSE 100 UCITS ETF	€52,029,957	1.4%	
Amundi MSCI Japan ETF	€50,201,610	1.4%	
UBS Core SPI ETF	€41,120,698	1.1%	
SPDR SP Eur Div Aristocrats ETF	€39,797,888	1.1%	
SPDR Russell 2000 US SmlCp ETF	€37,027,080	1.0%	
Schroder Global Equity Alpha	€131,226,046	3.6%	Aksione - Aktive/Rritje
Nordea GSE	€115,153,476	3.2%	
Schroders Sustainable Growth	€100,313,341	2.8%	
JPM Global Select Equity €H	€96,174,857	2.6%	
iShares Listed Private Equity	€33,997,695	0.9%	Aksione - Tematike/Rritje
BNP Healthcare Innovators	€32,527,273	0.9%	
VanEck Defense ETF	€28,725,836	0.9%	
Future of Defence ETF		0.8%	
iShare US Infr ETF	€105,988,713	2.9%	Asete reale / Stabilitet
GlobalX US Infr ETF	€79,266,892	2.2%	
Global X Data Center & Digital Infrastructure ETF	€46,673,097	1.3%	
iShare Resid. M-Factor R. Estate ETF	€31,349,134	0.9%	
iShares U.S. Digital Infrastructure and Real Estate	€19,960,758	0.5%	
Schroder ISF Global MA Bal	€149,422,332	4.1%	Multi-asete / Stabilitet
Allianz Dynamic Multi Asset	€97,647,525	2.7%	
Blackrock Global Allocation	€93,735,475	2.6%	
Afatizim bankar	€193,378,62	5.3%	Depozita me afat / Stabilitet
Obligacione të Kosovës	€110,546,591	3.0%	Obligacione - Thesari Kosovë / Stabilitet
Obligacione të Austrisë	€32,278,060	0.9%	Obligacione - Rang Investues / Stabilitet
Obligacione të Francës	€31,434,257	0.9%	
Obligacione të Italisë	€30,043,767	0.8%	
Amundi Smart Overnight Return ETF	€102,396,721	2.8%	Kesh/Taktikë
Amundi Euro Liquidity	€145,659,876	4.0%	Treg i parasë / Likuiditet
Keshi në banka	€16,410,280	0.5%	Kesh/Likuiditet
Gjithsej	€3,645,541,760	100%	



Investimet, sipas fondeve investuese dhe plasmaneve në Kosovë, për Portofolin e Balancuar më 31.08.2026:

Fondi investues / Institucioni	Shuma e investimit	% e investimit	Klasa e asetit / Strategjia
Vanguard GSIF	€83,968,609	16.8%	Aksione – Pasive / Rritje
Invesco S&P500 Eur Hedg ETF	€51,445,749	10.3%	
Amundi MSCI Japan ETF	€15,524,237	3.1%	
iShare MSCI Eur Value ETF	€15,139,168	3.0%	
iShares MSCI EM UCITS ETF	€9,557,166	1.9%	
iShares Core FTSE 100 UCITS ETF	€9,052,863	1.8%	
UBS Core SPI ETF	€5,140,087	1.0%	
Nordea GSE	€22,186,165	4.4%	Aksione – Aktive / Rritje
Schroder Global Equity Alpha	€20,238,365	4.1%	
JPM Global Select Equity €H	€18,652,093	3.7%	
Schroders Sustainable Growth	€18,032,911	3.6%	
BNP Healthcare Innovators	€4,984,344	1.0%	Aksione – Tematike / Rritje
Future of Defence ETF	€4,752,312	1.0%	
VanEck Defense ETF	€4,575,084	0.9%	
iShare Resid. M-Factor R. Estate ETF	€7,791,951	1.6%	Asete reale / Stabilitet
Global X Data Center & Digital Infrastructure ETF	€4,325,043	0.9%	
iShare US Infr ETF	€4,212,396	0.8%	
Schroder ISF Global MA Bal	€18,645,475	3.7%	Multi-asete / Stabilitet
Allianz Dynamic Multi Asset	€9,115,472	1.8%	
Blackrock Global Allocation	€7,704,732	1.5%	
Afatizim bankar	€56,682,388	11.4%	Depozita me afat / Stabilitet
Obligacione të Kosovës	€101,135,709	20.3%	Obligacione - Thesari Kosovë / Stabilitet
Amundi 3M-I	€3,855,347	0.8%	Treg i parasë / Likuiditet
Keshi në banka	€2,317,589	0.5%	Kesh / Likuiditet
Gjithsej	€499,035,255	100%	

Investimet, sipas fondeve investuese dhe plasmaneve në Kosovë, për Portofolin Konservativ më 31.08.2026:

Fondi investues / Institucioni	Shuma e investimit	% e investimit	Klasa e asetit / Strategjia
Obligacione të Kosovës	€163,522,854	82.9%	Obligacione - Thesari Kosovë/ Stabilitet
Afatizim bankar	€18,600,293	9.4%	Depozita me afat / Stabilitet
Amundi Euro Liquidity	€14,114,590	7.2%	Treg i parasë / Likuiditet
Keshi në banka	€1,107,808	0.6%	Kesh / Likuiditet
Gjithsej	€197,345,546	100%	

4.3 Pensionimi i kontribuuesve

Sipas legjislacionit në fuqi, kontribuuesit mund të aplikojnë për tërheqje të kursimeve pensionale nga FKPK-ja në këto raste:
1) Pension moshe (kur kontribuesi arrin moshën 65 vjeçare)
2) Pension invaliditeti (në rast të humbjes së përkohshme ose të përhershme të aftësisë për të punuar);
3) Trashëgimi pensioni (në rastin e vdekjes së një kontribuuesi)

Ndaras këtyre, legjislacioni iu jep mundësinë të gjithë shtetasve të huaj që kanë kontribuar në FKPK, t'i tërheqin mjetet e tyre para arritjes së moshës së pensionimit.


Në vijim paraqesim numrin e kontribuuesve të pensionuar gjatë vitit 2026 sipas muajve dhe shumave të tërhequra, për të dhënat që ishin në dispozicion në momentin e përgatitjes së këtij raporti.

Numri i kontribuuesve të pensionuar gjatë vitit 2026 sipas muajve dhe shumave të tërhequra:

Periudha	Numri i të pensionuarve	Shuma e përfituar
Janar	753	€7,432,479
Shkurt	800	€7,705,946
Mars	824	€9,066,082
Prill	814	€8,271,014
Maj	765	€9,089,367
Qershor	714	€7,530,888
Korrik	465	€7,523,736
Gusht	637	€7,177,306

Përfituesit e pensionit sipas kategorisë së pensionimit:

Periudha	Pension moshe	Pension i trashëguar (raste të vdekjes)	Pension invaliditeti	Shtetas të huaj
Janar	581	64	105	3
Shkurt	622	84	91	3
Mars	660	75	86	3
Prill	621	93	99	1
Maj	608	65	91	1
Qershor	567	72	69	6
Korrik	561	81	111	12
Gusht	494	84	58	1



5. Synimet kryesore për vitin 2027

FKPK-ja, përmes strukturave vendimmarrëse dhe stafit të saj, dhe në harmoni me synimet e Bordit Drejtues, i ka përcaktuar synimet zhvillimore kryesore për vitin e ardhshëm. Këto synime gjithsesi shkojnë në drejtim të përmbushjes së misionit të institucionit, por edhe lëvizjes drejt përmbushjes së ambicies dhe arritjes së vlerave të institucionit.

Synime kryesore vjetore për vitin 2027 janë:
5.1 Investimi i mjeteve pensionale.
5.2 Avancimi kapaciteteve profesionale të njësisë së investimeve.
5.3 Mirëmbajtja e vazhdueshme e shërbimit për klientë.
5.4 Vazhdimi i implementimit të planit të marrëdhënieve me publik.
5.5 Përmirësimi dhe plotësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit.
5.6 Plotësimi i të gjitha pozitave të përhershme me staf.

5.1 Investimi i mjeteve pensionale.

FKPK-ja do t'i realizojë investimet e mjeteve pensionale duke u bazuar në Deklaratën e Parimeve të Investimeve (DPI), në fuqi prej 1 prillit 2024 dhe me plotësimet e mëpasme. DPI-ja është përpiluar duke u bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi: Ligjin Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-115, Ligji Nr. 04/L-168 dhe Ligjin Nr. 05/L-116 si dhe rregullat dhe rregulloret përkatëse të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK).

Zbatimi i DPI-së fillon nga Njësia e Investimeve, vazhdon me Bordin Menaxherial dhe konfirmohet nga Komisioni I Investimeve i Bordit Drejtues. Sikurse ishte planifikuar, prej prillit 2024 ka filluar
zbatimi i tre portofolave investues:
1) Portofoli Standard (për moshën 15 deri 57 vjeç);
2) Portofoli i Balancuar (për moshën 58 deri 62 vjeç) dhe
3) Portofoli Konservativ (për moshën 63 vjeç e sipër).

Kjo ndarje e kontribuuesve sipas moshës së tyre (e me qëllim menaxhimin më të mirë të riskut investues) do të vazhdojë se zbatuari edhe përgjatë vitit 2027.

5.2 Avancimi i kapaciteteve profesionale të njësisë së investimeve.

Më 2026 Njësia e Investimeve është kristalizuar me konfigurimin e stafit të gatshëm për të ofruar analiza investuese dhe rekomandime profesionale sipas nevojave të Bordit Menaxherial, Komisionit të Investimeve dhe Bordit Drejtues.

Përgjatë vitit 2027 synohet që kjo Njësi të avancohet tutje përmes pjesëmarrjes së stafit në aktivitete dhe trajnime ndërkombëtare në fushën e investimeve, duke përgatitur kështu kapacitete profesionale të gatshme për t'u përballur më mirë me ndryshimet e vazhdueshme në tregjet financiare globale. Gjithashtu pritet të rritet tutje mbulueshmëria e klasave të aseteve, zonave globale dhe sektorëve të ndryshëm investues, për të arritur alokim optimal të ekspozimeve brenda secilit portofol investues.

5.3 Mirëmbajtja e vazhdueshme e shërbimit për klientë.

Ndryshimet e bëra në trajtimin e riskut investues, me ndarjen e kontribuuesve nëpër portofola të ndryshëm investues (proces i rrumbullakuar në prill 2024), ka nxitur (pritshëm) dhe ka vazhduar të jetë pjesë e interesimit të kontribuuesve përgjatë vitit 2026.

Gjithashtu, më 2025 ka filluar procesi i ofrimit të shërbimit online për aplikim përmes eTrustit për pensionimin e moshës dhe invaliditetit. Ky shërbim ka gjetur interesim të mënjehershëm tek kontribuuesit, duke dëshmuar nevojën e implementimit dhe mirëmbajtjes së tij. Andaj edhe përgjatë vitit 2027 do të mbikëqyret me kujdes të veçantë, që të vazhdojë të jetë i sigurt dhe lehtëqasshëm nga interneti.

Në vazhdim të përmirësimit të shërbimeve, përgjatë vititeve 2025 - 2026 është shtuar numri i bankave që FKPK-ja ka marrëveshje për ta ofruar shërbimin e tërheqjes në faza për të pensionuarit nga FKPK-ja, duke iu ofruar atyre lehtësi, zgjedhje më të gjërë dhe përfitime shtesë. Kjo do të vazhdoj edhe më tej, me qëllimin përfundimtar që të gjitha bankat në Kosovë ta ofrojnë këtë shërbim për të pensionuarit e FKPK-së.

5.4 Vazhdimi i implementimit të planit të marrëdhënieve me publik.

Departamenti I marrëdhënieve me publik ka filluar procesin e ridizajnimit të faqës zyrtare në internet të FKPK-së dhe kjo pritet të përfundoj në gjysmën e parë të vitit 2027.

FKPK ka vazhduar publikimet dhe komunikimet e rregullta të cilat zhvillohen kryesisht përmes faqes zyrtare dhe rrjeteve sociale (Facebook dhe LinkedIn), platforma këto që janë edhe popullore e profesionale.

5.5 Përmirësimi dhe plotësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit.

FKPK-ja e njeh rëndësinë e pazëvendësueshme të teknologjisë informative dhe të komunikimit, andaj synon ta mbajë hapin me zhvillimet teknologjike, sidomos në fushën e sigurisë së informacionit por edhe të aplikimit të zgjidhjeve efikase e të sigurta.

Në këtë kontekst FKPK-ja vazhdon t'i ketë prioritetet si në vijim në fushën e teknologjisë së informacionit:


- Zbatimi i ndryshimeve gjithëpërfshirëse për politikat dhe procedurat e TI-së në përputhje me Strategjinë 2024-2027;
- Përmirësimi i sistemeve që rrisin nivelin e sigurisë kundër rreziqeve kibernetike;
- Rifreskimi i pajisjeve harduerike siplas planit pesëvjeçar, përfshirë kompjuterët për stafin;
- Avancimi i proceseve dokumentuese;
- Testimin periodik për Rimëkëmbje në rast të fatkeqësive sipas Planit për vazhdimësinë e operimit;
- Vëzhgimin e vazhdueshëm për sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave në posedim;
- Mirëmbajtjen e softuerit për menaxhimin e llogarive të pjesëmarrësve (IPSA);
- Implementimin e rekomandimeve të realizueshme nga proceset audituese dhe inspektuese;
- Trajnimi profesional i stafit të TI-së me fokus sigurinë e sistemeve të informacionit.

5.6 Plotësimi i të gjitha pozitave të përhershme me staf.

Largimet eventuale të stafit, ose krijimi i pozitave të reja të përhershme, deri në fund të këtij viti do të jenë pjesë e synime për t'u përmbushur sa më parë përgjatë vitit 2027. Kjo me qëllim që institucioni ta ketë vazhdimisht të plotë dhe funksionale strukturën organizative në fuqi, e sipas nevojave të institucionit.

6. Struktura organizative e FKPK-së

Në vijim prezantohet Struktura Organizative e FKPK-së.



7. Njësitë organizative dhe detyrat

Administrata e FKPK-së drejtohet nga Menaxhmenti i lartë, i cili përbëhet nga Drejtori Menaxhues dhe tre drejtorë. I gjithë stafi tjetër operon brenda nëntë njësive sikurse në vijim:

1. NJËSIA PËR INVESTIME
Vlerëson zhvillimet në tregje financiare dhe përspektivën makro-ekonomike globale. Ofron analiza mbi alokimin e aseteve dhe përgatitë rekomandime investuese tek Bordi Menaxherial për portofolet investuese të FKPK-së, në përputhje me DPI. Përgatitë raportin vlerësues për angazhimin e menaxhuesëve të mjeteve dhe monitorimin e performancës së tyre. Implementon shitblerjen e instrumenteve financiare të tregtueshme

2. NJËSIA PËR RAPORTIM DHE PËRMBUSHJE
Përgatitë raportet periodike për Bordin Drejtues dhe Rregullatorin mbi pajtueshmërinë e investimeve të FKPK-së. Udhëheq procesin e vendosjes së marrëdhënieve ndërpalëshe me menaxhuesit e mjeteve si dhe mban korrespodencën lidhur me tarifat menaxhuese dhe dokumentacionin periodik.

3. NJËSIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT
Sigurojnë që e gjithë infrastruktura e teknologjisë së informacionit funksionon gjithë kohën e pa probleme: kujdesen për harduerët, softuerët, licencat, rrjetin e jashtëm e të brendshëm të FKPK-së, sigurinë e rrjetit dh të dhënave dhe ruajtjen e të dhënave. Kujdesen që plani i rimëkëmbjes është çdo ditë i vlefshëm dhe e testojnë në baza të rregullta.

4. NJËSIA E SHËRBIMIT PËR KLIENTË
Ofron shërbimet ndaj klientëve. Kujdeset të informojë për llogaritë individuale që nga pagesa e kursimeve pensionale, bilancet e kursimeve dhe po ashtu këshillon kontribuuesit për pensionet e i ndihmon ata gjatë aplikimit për tërheqjen e kursimeve. I mirëmban marrëdhëniet edhe me punëdhënësit, me qëllim të përmirësimit të informacionit që mundëson barazimin e kontributeve nëpër llogaritë individuale. Në përgjithësi, ky staf është afër klientit gjatë gjithë ciklit të kursimit e deri në pensionim.

5. NJËSIA E FINANCAVE DHE E KONTABILITETIT
I kryen të gjitha transaksionet financiare, përfshirë investimin dhe/ose tërheqjen e mjeteve në tregjet financiare; llogarimbjajten dhe kontabilitetin për mjetet pensionale dhe operacionet e FKPK-së.

Po ashtu, kalkulojnë çmimin ditor të aksionit (për tre portofolat) dhe i përgatisin pasqyrat financiare, raportet mujore e tremujore dhe raportet e tjera të nevojshme për Bordin e FKPK-së, Rregullatorin dhe Kuvendin, si dhe komunikojnë me menaxhuesit e mjeteve.

6. NJËSIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIK
E ndërton dhe e mbështet komunikimin e institucionit me medien, publikun dhe institucionet; zhvillimin e intervistave dhe konferencave, përpilimin e raportit vjetor dhe buletinit tremujor; administrimin e uebfaqes dhe llogarive të FKPK-së në rrjetet sociale dhe (menaxheri i njësisë) e merr rolin e zëdhënësit, kur i delegohet; përgatit raportet e qasjes në dokumentet publike dhe planin vjetor të performancës, koordinon dhe ndihmon përkthimin e dokumenteve. Gjithashtu e realizon gjithë komunikimin me shkrim me kontribuuesit (përmes e-mailni info@trusti.org dhe ankesa@trusti.org) dhe kryen autorizimin e llogarive në eTrusti.

7. NJËSIA E BURIMEVE NJERËZORE
Kujdesen për listëprezencën e stafit në punë, respektimin e orarit, përgatitjen e listës së pagave, kompensimeve të tjera dhe mbajtjen e arkës. Përveç këtyre merret me furnizimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e zyrës; arkivimin e dokumenteve të institucionit; mbështetjen e stafit dhe Bordit në takime e udhëtime, brenda e jashtë vendit.

8. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM
E siguron Bordin se e gjithë veprimtaria e Menaxhmentit dhe Administratës dhe proceset në FKPK janë në përputhje me procedurat e brendshme, rregullat e BQK-së dhe ligjet në fuqi. Siguron efektivitetin dhe përshtatshmërinë e sistemit të FKPK-së dhe kontrolleve të brendshme, duke zhvilluar auditime të rregullta tremujore dhe ofruar rekomandime për zgjidhjen e çështjeve të ngritura. Raportet e Auditorit shqyrtohen nga Komisioni i Auditimit dhe Bordi Drejtues.

9. NJËSIA LIGJORE
Zyra ligjore e shqyrton ligjshmërinë e gjithmbarshme të institucionit karshi legjislacionit në fuqi dhe ndihmon në përpilimin e kontratave, marrëveshjeve; dhënien e opinioneve ligjore dhe e përfaqëson FKPK-në në systemin gjyqësor. Zyrtarja Ligjore është edhe Sekretare e Bordit Drejtues.



8. MATRICA E PLANIT TË VEPRIMIT PËR VITIN 2027

Nr.	Aktiviteti	MUAJT 1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1.	Pranimi/barazimi i kontributeve pensionale												
2.	Kthimi në ATK i mjeteve të pabarazuara												
3.	Ndërmarrja e veprimeve investuese (shtimi, ndryshimi dhe/ose tërheqja e investimeve)												
4.	Pagesa mujore e pensioneve												
5.	Mirëmbajtja e sistemit të menaxhimit të llogarive (IPSA)												
6.	Vlerësimi vazhdueshëm dhe analizat për investimet												
7.	Shërbimi për klientë në distancë (eTrusti, uebfaqja, e-mail, telefon)												
8.	Përditësimi i uebfaqes së FKPK-së												
9.	Dërgimi dhe publikimi i raporteve tremujore (BQK, Kuvend, ueb)												
10.	Mbledhjet e rregullta të Bordit Drejtues												
11.	Përgatitja e Raportit Vjetor 2026 dhe dërgimi në Kuvend												
12.	Konferenca dhe/ose kumtesa vjetore për medie												
13.	Rishikimi i buxhetit vjetor												
14.	Përgatitja e tarifave, buxhetit dhe planit vjetor si dhe dërgimi në Kuvend për shqyrtim												
15.	Auditimi i pasqyrave financiare nga Auditori i Jashtëm												
16.	Inspektimi vjetor nga BQK-ja												
17.	Auditimi i teknologjisë së informacionit												
18.	Rimbursimi i kontribuuesve nga tërheqja e 10%-shit												
19.	Implementimi i planit operativ të marrëdhënieve me publik												
20.	Gjenerimi dhe dërgimi i pasqyrave vjetore tek kontribuuesit (me Postë dhe e-mail)												
21.	Testimi vjetor i planit për rimëkëmbje												

9. Projeksioni dhe plani i të hyrave për vitin 2027

Veprimtaritë e FKPK-së financohen duke iu ngarkuar llogarive individuale të kontribuuesve në skemën e kursimeve pensionale tarifa të arsyeshme të bazuara në shpenzimet për investimin e mjeteve pensionale dhe shpenzimet për operim të zyrës së FKPK-së.
Sipas Nenit 2.1 të Ligjit Nr. 04/L-168 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-101:

"Kuvendi i Kosovës cakton tarifën investuese dhe operacionale në bazë të kërkesës së FKPK-së për çdo vit kalendarik. Kërkesa duhet të jetë e specifikuar me të gjitha shpenzimet e përllogaritura për periudhën për të cilën paraqitet kërkesa".

Sipas Nenit 4.15 dhe Nenit 5.2 paragrafi j) të Ligjit Nr. 04/L-101, Bordi Drejtues gëzon të drejtën për të miratuar buxhetin e FKPK-së, dhe bazuar në këtë të drejtë e ka miratuar buxhetin për vitin 2027.

Niveli i tarifave të propozuara, për financimin e shpenzimeve operacionale dhe investuese të FKPK-së, ndër të tjera, varet edhe nga kontributet e reja, tërheqjet e kursimeve (p.sh. nga pensionimi i kontribuuesve), gjegjësisht nga mjetet që do t'i ketë FKPK-ja nën menaxhim gjatë vitit.

Kështu, nga vlerësimet e bëra, pritjet për vitin 2027 janë:

- Viti të fillojë me 4,411 milionë EUR MNM.
- Kontributet e arkëtuara të jenë 432 milionë EUR.
- Tërheqja e kursimeve të jetë 102 mln EUR.
- Viti të përfundojë me 4,741 mln EUR MNM.
- Mesatarja e MNM-ve të jetë rreth 4,576 milionë EUR.

Bazuar në vlerësimet ë mësipërme, buxheti i miratuar nga Bordi Drejtues për aktivitetet operacionale për vitin 2027 është projektuar të jetë 2,138,200 EUR ose për 146,000 EUR më i lartë sesa buxheti për vitin paraprak (2026 ishte: 1,992,200 EUR).

Taksa operacionale për vitin 2027 është propozuar të jetë me normën 0.043% e mjeteve, një ulje kjo nga norma aktuale 0.047%.

Në anën tjetër, vlerësimi i shpenzimeve investuese varet kryesisht nga alokimi i pritshëm i mjeteve nëpër fondet investuese për vitin 2027, si dhe kostot që i ngarkojnë menaxhuesit e këtyre fondeve.

Bazuar në këto dy elemente, si dhe shpenzimet e pritshme për transferet ndërkombëtare dhe kujdestarinë e mjeteve, mesatarja e ponderuar e shpenzimeve investuese pritet të jetë rreth 0.25% e mjeteve mesatare përgjatë vitit. Kjo tarifë është më e ulët sesa vitin paraprak prej 0.30%. Në vlerë nominale kjo tarifë pritet të sjell të hyra prej 11,452,576 euro për vitin 2027.

- Rekomandimi për Kuvendin

Duke u bazuar në shpjegimet e mësipërme, Bordi Drejtues i FKPK-së i ka rekomanduar Kuvendit të Republikës së Kosovës që t'i miratojë për vitin 2027:
1. Tarifën investuese vjetore prej 0.25% të mjeteve;
2. Tarifën operacionale vjetore prej 0.043% të mjeteve.
Sipas këtij rekomandimi, gjithsej tarifat e ngarkuara mbi mjetet pensionale do të uleshin nga 0.347% sa janë aktualisht, në 0.293% të mjeteve përgjatë vitit 2027 – pra, në nivelin më të ulët që nga themelimi.

